




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-516/2013
Nr. i faq. Broj stranica 02	Data Datum 20.02.2013
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.02.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr.AKK-03-2435\12, për zyrtarin e lartë z.Nenad Cvetkoviç, Kryetar i Komunës së Parteshit, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia kundër Korrupsionit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqitën rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të Interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-2435/12, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Nenad Cvetkoviç, Kryetar i Komunës së Parteshit.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Kryetar i Komunës së Parteshit, ka qenë duke ushtruar edhe funksionin e personit të autorizuar në biznesin privat me emër TP "M&L-Com", që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të Interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 15.08.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave zyrtari i lartë z.Nenad Cvetkoviç, Kryetar i Komunës së Parteshit, ka kontaktuar me ne, dhe ka kërkuar një takim, për ta njoftuar dhe informuar më detal.

Zyrtaret e Agjencisë kanë shkuar në takim me zyrtarin e lartë, z.Cvetkoviç, ku dhe janë njoftuar nga ai, se në momentin që ka marrë shkresën ka filluar procedurën për mbyllje të biznesit që ka qenë i regjistruar, mirëpo është arsyetuar se për shkak të procedurave të administratës tatimore i duhet të pres deri sa ata të përfundojnë procedurat e tyre e pastaj të fillon mbylljen në ARBK.

Agjencia kundër Korrupsionit ka qenë në kontakt me zyrtarin, dhe janë informuar në vazhdimësi, deri sa ka përfunduar i tërë procesi i mbylljes së biznesit privatë.

Me datë 01.02.2013, z.Nenad Cvetkoviç, Kryetari Komunës së Parteshit, ka sjell në zyrat e Agjencisë kundër Korrupsionit, dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, se ka përfunduar procesi i mbylljes së biznesit me emër TP "M&L-Com", ku pronar dhe person i autorizuar ishte vet z.Nenad Cvetkoviç..

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve dhe në bazë të gjendjes së krijuar në këtë proces konstatojmë se :

Zyrtari i lartë z.Nenad Cvetkoviç, Kryetar i Komunës së Parteshit, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit, dhe nuk gjendet me në situatën e përshkruar si konflikt të mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, pasi që ka bërë ndryshimet e kërkuara në biznesin e tij privatë, dhe ka bërë, shuarjen vullnetare të këtij biznesi.

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si, Kryetar i Komunës së Parteshit, dhe funksionit si personit i autorizuar në biznesin privat me emër TP "M&L-Com".

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqitën rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

